REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| PRANUAR | 06 / 10 / 2025 | | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01 | 052/01- | 44117 | |



# RAPORT I DEGJIMEVE BUXHETORE

## BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2026 dhe PROJEKSIONET PËR VITET 2027 - 2028




Zhvillim Ekonomik



Infrastrukturë



Sport

Për një të ardhme më të mirë

*F a l ë n d e r i m...*

*Grupi punues falënderon Kryetarin e Komunës, z. Ramiz Lladrovci, për gatishmërinë dhe pjesëmarrjen e tij aktive në të gjitha dëgjimet buxhetore, duke dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në diskutime, në dëgjimin e kërkesave të qytetarëve dhe në ndërtimin e një buxheti që reflekton nevojat reale të komunitetit.*

*Në veçanti, grupi punues falënderon projektin DEMOS, me përfaqësues z. Drilon Shala, për bashkëpunimin e ngushtë dhe mbështetjen profesionale gjatë procesit të konsultimeve publike dhe hartimit të buxhetit komunal për vitin 2026. Ky kontribut ka qenë thelbësor për zhvillimin e një procesi gjithëpërfshirës, transparent dhe në përputhje me praktikat më të mira të qeverisjes lokale.*

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| PRANUAR | 06/10/ 2025 | | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01 | 052/01- | 44117 | |


# RAPORT PËRMBLEDHËS PËR ORGANIZIMIN E KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PLANIFIKIMIN, PËRPILIMIN DHE MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 – KOMUNA E DRENASIT

## 1. HYRJE

Përmes këtij Raporti përmbledhës të Konsultimeve Publike synohet që të dokumentohen të gjitha format e konsultimit publik që i kanë paraprirë përpilimit/draftimit të projekt-propozimit të buxhetit nga ana e ekzekutivit të komunës. Kjo nënkupton që përfshihen takimet publike obligative të mbajtura në gjashtëmujorin e parë nga ana e Kryetarit, format të konsultimit publik në të shkruar, dëgjimet buxhetore për KAB e po ashtu ato për buxhet vjetor, etj.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna 04/2023, përcaktohen rregullat që sigurojnë përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve përfaqësuese në vendimmarrje lokale, transparencën dhe llogaridhënien e organeve të komunës, gjithashtu përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore në komunë si dhe obligimet e komunave për të siguruar qasjen nëpërmjet teleprezencës dhe teknologjisë digjitale për të garantuar transmetimin në distancë dhe monitorimin nga autoritetet qendrore, shoqëria civile dhe qytetarët. Sipas këtij Udhëzimi, Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e: 1.1 Takimeve publike; 1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave; 1.3 Takime konsultative me qytetarë; 1.4 Dëgjime buxhetore.

Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe dokumenteve lokale. Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt- propozimit gjatë mbajtjes së konsultimit publik mbledh komentet dhe përgatit raport për rezultatet e konsultimit publik.

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, respektivisht Nenit 60, përcaktohet se përgatitja dhe rishqyrtimi i propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore bëhet nga Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe Kryetari i Komunës, ku ZKF duhet, me ose para 1 Korrikut të vitit aktual kalendarik, t'i dërgojë kryesuesit të secilit departament komunal të komunës një qarkore buxhetore komunale e cila përmban informata dhe udhëzime mbi

(i) tavanet e shpenzimeve të aplikueshme për departamentin përkatës për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime mbi këto tavane për dy (2) vitet e ardhshme fiskale, dhe

(ii) (ii) metodologjinë dhe formularët që duhet të shfrytëzohen nga departamenti përkatës gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal. Kjo qarkore buxhetore duhet të përfshijë: a) procedurat që duhet përdorur nga departamenti gjatë përgatitjes së propozim buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore; b) të dhënat të cilat duhet të parashtrohen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore; c) detale mbi formatin në të cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore; dhe d) afatin e fundit deri në të cilin departamenti duhet të përfundojë dhe t'i dorëzojë ZKF-së propozimbuxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore.

Pas miratimit të propozim-Buxhetit Komunal nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës, deri me 1 Shtator të vitit përkatës fiskal, duhet t'ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal. Propozim-Buxheti Komunal duhet të përfshijë:

a) parashikime dhe supozime ekonomike dhe buxhetore;
b) vlerësime të përgjithshme të të ardhurave nga të gjitha burimet, duke përfshirë (i) grantet, në përputhje me shumat e këshilluara në qarkoren(t) buxhetore të nxjerra nga Ministri, (ii) ndihmën nga burimet jashtë Kosovës, dhe (iii) të ardhurat e parashikuara vetanake të komunës;
c) një cak të përgjithshëm të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimit;
d) vlerësime të përkrahjes së pritur nga donatorët; dhe
e) çfarëdo të dhëna të tjera me rëndësi materiale për buxhetin të cilat ZKF e konsideron të arsyeshme për t'u përfshirë.

## 1.1 ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PLANIFIKIMIN DHE PËRPILIMIN E PROPOZIM-BUXHETIT KOMUNAL

Grupi punues i mbështetur nga projekti DEMOS ka realizuar një punëtori dy ditore për hartimin e planit të dëgjimeve buxhetore e po ashtu për mënyrën e planifikimit, organizimit, lehtësimit dhe veprimeve përcjellëse të dëgjimeve buxhetore dhe gjithë procesit të planifikimit të buxhetit.

Plani i dëgjimeve buxhetore është hartuar dhe gjithashtu është publikuar në ueb faqen dhe rrjetet sociale të Komunës.

Hartimi i këtij dokumenti ka ardhur edhe pas mbajtjes së konsultimeve publike (dëgjimeve buxhetore) me qytetarët për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 dhe atyre për projekt-propozimin e buxhetit për vitin 2026.

Pas themelimit të Grupit Punues për dëgjimet buxhetore 2025–2027, sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Drenasit nr. 01-400/01-8037, të datës 27/02/2025, dhe shpalljes së

ftesës për pjesëmarrje në dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028, nr. 01- 060/03-18323, të datës 19/05/2025, janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar një proces të hapur, gjithëpërfshirës dhe transparent. Këto veprime janë bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Drenasit, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

Të gjithë qytetarët, administratorët e vendbanimeve, përfaqësuesit e lagjeve, OJQ-të, shoqatat e grave, shoqëria civile, bizneset dhe palët e tjera të interesuara janë njoftuar se më datën 19.05.2025 kanë filluar dëgjimet buxhetore për pranimin e komenteve, propozimeve dhe kërkesave për hartimin e KAB-it 2026–2028. Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft-Buxheti Komunal 2026–2028 kanë qenë dhe mbeten dokumente me rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe mirëqenien e komunës, prandaj pjesëmarrja aktive e qytetarëve ka qenë thelbësore për të ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Komentet dhe propozimet janë pranuar deri më 30.05.2025, ora 16:00, në adresat zyrtare të emailit: albulena.saliuku@rks-gov.net, bekim.dobra@rks-gov.net, avdyl.mziu@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net.

Në të dy dëgjimet buxhetore të mbajtura për KAB 2026-2028, temat kryesore ishin të fokusuara në:

- Hartimin dhe prezantimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026–2028
- Prioritetet investuese për infrastrukturën rrugore, ujësjellësit, ndriçimin publik dhe kanalizimin
- Përmirësimin e kushteve në arsim dhe kujdes shëndetësor
- Mbështetjen për zhvillimin rural dhe bujqësinë
- Aktivitetet rinore, kulturore dhe sportive
- Rritjen e transparencës dhe digjitalizimin e shërbimeve komunale

## Narrativi për dëgjimet buxhetore, konsultimet publike dhe përbërjen e grupit punues

- Procesi i hartimit të buxhetit komunal për vitin vijues ka qenë i strukturuar dhe gjithëpërfshirës, duke kombinuar dëgjimet publike me përbërjen e grupeve punuese të krijuara për këtë qëllim. Sipas raportit të Kuvendit, për hartimin e buxhetit është formuar një grup punues me përfaqësues nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, drejtoritë përkatëse komunale dhe përfaqësues nga komunitetet lokale. Ky grup ka pasur përgjegjësi të drejtpërdrejtë për koordinimin e dëgjimeve buxhetore, mbledhjen dhe sistemimin e kërkesave qytetare, si dhe për hartimin e dokumenteve përfundimtare të buxhetit, duke siguruar që çdo propozim të shqyrtohet në mënyrë të balancuar dhe transparente.
- Gjatë dëgjimeve buxhetore, të organizuara në nivel lokal, qytetarët dhe komunitetet kanë pasur mundësi të paraqesin nevojat dhe prioritetet e tyre konkrete, duke përfshirë fusha të tilla si infrastrukturë rrugore, ndriçim publik, ujësjellës, mjedis dhe investime

në arsim e shëndetësi. Të gjitha komentet e pranuara janë dokumentuar dhe janë analizuar nga grupi punues për t'u reflektuar në buxhetin final.

- Përveç dëgjimeve fizike, janë zhvilluar edhe forma të tjera të konsultimit publik. Kjo ka përfshirë dorëzimin e komenteve me shkrim, si dhe përdorimin e platformave elektronike të komunës, përfshirë faqen zyrtare dhe rrjetet sociale, ku qytetarët kanë pasur mundësinë të dorëzojnë sugjerime dhe të marrin informacion mbi procesin buxhetor. Këto forma të konsultimit kanë rritur pjesëmarrjen e komunitetit dhe kanë forcuar transparencën dhe llogaridhënien në procesin e planifikimit financiar.
- Në përfundim, kombinimi i dëgjimeve publike, konsultimeve elektronike dhe koordinimi nga grupi punues ka mundësuar ndërtimin e një buxheti komunal gjithëpërfshirës, i cili reflekton nevojat reale të qytetarëve dhe respekton parimet e transparencës, bashkëpunimit dhe përfaqësimit të drejtë të komuniteteve.
-

**Publikimet për këto dëgjime buxhetore janë të vendosura në linqet në vijim:**

Link – Plani i konsultimeve publike me qytetarë për vitin 2025
https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/12/Plani-i-punes-dhe-plani-i-konsultimit-publik-2025.pdf

Link – Ftesë për pjesëmarrje në dëgjimet buxhetore për KAB 2026-2028
https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Ftese.pdf

Link – Kalendari i Dëgjimeve Buxhetore për Projekt-Propozim Buxhetin 2026
https://gllogoc.rks-gov.net/news/komuna-e-drenasit-publikon-kalendarin-e-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026/

Link – Moduli i dëgjimeve buxhetore në uebfaqen komunale ku gjenden të gjitha dokumentet që i nënshtrohen dhe janë relevante për konsultimet publike që kryen komuna e Drenasit
https://gllogoc.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/

## 2. PËRMBLEDHJE TABELARE E KONSULTIMEVE TË MBAJTURA PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2026-2028 DHE PROPOZIM-BUXHETIN VJETOR PËR VITIN 2026

| Grupi i interesit / Me kë është mbajtur dëgjimi | Lokacioni | Data | Nr. total i pjesëmarrësve | Gra | Burra |
|---|---|---|---|---|---|
| **Administrator, Keshilla Lokal, Gra, te rinje, studente, pensioniste, persona me aftesi te kufizuara, punetor shendetesor etj.** | Salla e Kuvendit | 26.05.2025 | 45 | 13 | 32 |
| **Biznese, fermerë, OJQ, shoqeri civile, klubet sportive, klubet artistike, etj.** | Salla e Kuvendit | 26.05.2025 | 52 | 17 | 35 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Dobroshec (Dobroshec, Godanc, Gllanasellë, Likoshan, Çikatovë e Vjetër dhe Gradicë** | Objekti i shkollës fillore "Rlindja" në Dobroshec | 18.08.2025 | 35 | 6 | 29 |
| **Tërstenik (Tërstenikut I dhe II, Shtuticë, Polluzhë dhe Vërboc)** | Objekti i Shkollës fillor "Zenel Hajdini" në Tërstenik | 18.08.2025 | 30 | 8 | 22 |
| **Baicë (Baicë,Tërdec, Abri, Damanek dhe Krajkovë)** | Objekti i shkollës fillore "Migjeni" në Baicë | 19.08.2025 | 21 | 3 | 18 |
| **Arllat (Arllat Gjergjicë, Negroc, Llapushnik, Bytyq, Vuçak)** | Objekti i shkollës fillore "Abedin Bujupi" në Arllat | 19.08.2025 | 24 | 2 | 22 |
| **Komoran (Komoran I,II,III,IV, Zabel i Ulët, Korroticë e Ulët, Zabel i Epërm, Korroticë e Epërme, Fushticë e Ulët dhe Fushticë e Epërme, Sankoc Nekoc dhe Kizharekë)** | Objekti i shkollës fillore "Xheladin Gashi" në Komoran | 20.08.2025 | 28 | 5 | 23 |
| **Drenas (Drenas I, II dhe III, Shtrubullovë, Gllobarë, Vasilevë, Poklek i Ri dhe i Vjetër)** | Salla e mbledhjeve e Kuvendit të Komunës | 20.08.2025 | 17 | 4 | 13 |
| **Gra, te rinje, student, pensioniste, persona me aftesi te kufizuara, punetor shendetesor, etj.** | Salla e Kuvendit të Komunës | 21.08.2025 | 29 | 16 | 13 |
| **Biznese, fermerë, OJQ, shoqeri civile, klubet sportive, klubet artistike, etj.** | Salla e Kuvendit të Komunës | 21.08.2025 | 27 | 10 | 17 |
| **Dëgjim Publik i Përgjithshëm me qytetarët e Komunës së Drenasit i organizuar nga Komiteti për Politikë dhe** | Salla e mbledhjeve të Kuvendit | 05.09.2025 | 19 | 8 | 11 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Financa dhe Kuvendi i Komunës | të Komunës | | | | |
| | | Total | 327 | 92 | 235 |

## 3. METODOLOGJIA DHE KRITERET PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT TË KËRKESAVE

Sipas Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna 04/2023, të gjitha propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet që janë paraqitur nga publiku brenda mënyrës dhe afatit kohor të përcaktuar me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik. Shqyrtimi i komenteve bëhet nga grupi punues i projekt propozimit i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara. Në këtë kapitull janë të paraqitura aspektet/kriteret si dhe terminologjia që grupi punues ka marrë për bazë për klasifikimin e statusit të kërkesave. Më poshtë janë të elaboruara detajisht këto aspekte dhe kritere.

**Pranim/Aprovim**: nënkupton që kërkesa konkrete e qytetarit konsiderohet se është e nevojshme për tu realizuar dhe si e tillë do të jetë pjesë e buxhetit për vitin 2026. Pra kërkesat e tilla, si për projekte kapitale, subvencione apo mallra & shërbime janë në buxhetin që i shkon kuvendit/asamblesë për miratim deri me 1 shtator.

**Adresim**: nënkupton që kërkesa e qytetarit adresohet te subjekti, palët, institucioni relevant. Kjo vlen dhe është relevante në rastet kur kërkesat apo propozimet e qytetarëve nuk janë në kompetencën komunale dhe janë përgjegjësi/kompetencë e një insitiucioni tjetër (si psh KEK-ut, Ujësjellësit, etj) dhe kur klasifikohet si e "Adresuar" nënkupton që Komuna do të adresoj apo ka adresuar kërkesën tek institucioni relevant. Adresuar po ashtu mund të nënkuptojë që një kerkesë e qytetarit vetëm se gjenë adresim në projektet ekzistuese komunale (të cilat mund të kenë filluar në vitet paraprake apo janë të planfikuara për vitet pasuese për të cilin po mbahet konsultimi) – që nënkupton se nëse grupi punues nuk është i qartë nëse kjo kërkesë do të jetë me saktësi shembull pjesë e projekteve të vitit 2026, do ta adresoj atë për shqyrtim/përfshirje në buxhet për vitet e ardhshme (term tjetër në këto raste përdoret "E konsideruar" apo "E marrë në konsideratë".

**Pjesërisht e pranuar/aprovuar**: Nënkutpon klasifikimin e kërkesave apo propozimeve të qytetarëve të cilat mund të përfshijnë disa lloj intervenimesh (psh. Në shtrimin e një rruge mund të kërkohet qe përveç asflatimit të rrugës, të punohet edhe në ndriqimin publik të asaj rruge apo edhe mbjelljen e drunjëve dekorativ/gjelbrimin përreth saj). Në këto raste, nëse komuna mund të ketë mundësi buxhetore apo thjesht të prioritizoj vetëm një segment të kesaj kërkese (shembull shtrimin e rrugës) atëherë arsyeton që për këto arsye, kërkesa aprovohet për shtrimin e rruges, mirepo për vitin 2026 nuk do të ketë mundesi intervenimi në ndriqim publik apo mbjelljen e drunjëve dekorativ. Si e tillë kërkesa mbetet pjesërisht e pranuar/aprovuar.

**E refuzuar**: Nënkupton kërkesat e qytetarëve të cilat nuk përfshihen në buxhetin e komunës për vitin 2026. Kjo mund të jetë për shumë arsye e që mund të përfshijnë: mungesën e

mjeteve financiare, fakti që kërkesa nuk bënë pjesë në prioritetet komunale, fakti që kërkesa është më shumë e natyrës individuale se sa me ndikim në komunitet, fakti qe për realizimin e kërkesës/investimit do të duhet fillimisht të mënjanohen probleme të ndryshme si shpronësimet apo fakti që menaxhimi i pronës nuk është në kompetencë komunale, etj.

## 4. TABELARI I DETAJUAR SIPAS KATEGORIVE TË KËRKESAVE DHE STATUSIT QË MARRIN

Tabelari në vijim paraqet listimin e kërkesave të pranuara, duke i kategorizuar ato në bazë të natyrës që kanë, nëpër kategoritë si në vijim:

- Kërkesat e qytetarëve të natyrës "projekte kapitale",
- Kërkesat e qytetarëve të natyrës "subvencione",
- Kërkesat e qytetarëve të natyrës "mallra&sherbime",
- Kërkesat për informacion apo pyetje të ndryshme rreth progresit në realizimin e "x" invesimit, apo dhënies së "x" subvencionit, e kështu me radhë.

Legjenda e sqarimit të elementeve që gjenden në tabelarin më poshtë:

- Kategorizimi/Emertimi lartë me Capital Letters se a janë kërkesat në vazhdim të natyrës "INVESTIME KAPITALE", "SUBVENCIONE", "MALLRA & SHËRBIME", apo "PYETJE/KËRKESË PËR INFORMACION/SUGJERIME"
- Kolona e pare tregon për "Kërkesat, sugjerimet, idetë, pyetjet e parashtruara në konsultim" dhe tregon në mënyrë sa më të detajuar se çfarë përfshinë kërkesa
- Kolona e dytë përfshinë "Emër mbiemër të përsonit apo organizatës që ka dhënë propozimin/kërkesën"
- Kolona e tretë përfshinë "Statusin e kërkesës se a është Pranuar/Aprovuar, Adresuar, Pjesërisht aprovuar, Refuzuar" – sipas kritereve dhe metodologjisë së përcaktuar më lartë në kapitullin e mëhershëm
- Kolona e fundit përmban "Përgjigjet dhe arsyeshmërinë e komunës/grupit punues rreth kërkesës/propozimit të qytetarit apo organizatës që ka parashtruar atë, që tregon se cila janë arsyet e klasifikimit të kërkesës/propozimit në Statusin që është përcaktuar. Këtu duhet të jepen arsye dhe përgjigje sa më të detajuara dhe konkrete në menyrë që qytetari apo organizata ta ketë të qartë se pse një kërkesë e tyre ka marrë statusin e tillë.

**KËRKESAT SI REZULTAT I DËGJIMEVE BUXHETORE TË MBAJTURA PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB 2026-2028)**

| INVESTIME KAPITALE | | | |
|---|---|---|---|
| **Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim** | **Emri i personit/organizatës** | **Statusi i kërkesës** | **Përgjigjia dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues** |
| Asfaltimi i rrugicave në disa lagje | Bajram Qallapeku | Pjesërisht pranuar | Grupi punues ka shqyrtuar me kujdes kërkesat për asfaltimin e rrugicave në disa lagje dhe ka vlerësuar se aty ku rrugët dhe rrugicat janë të regjistruara si |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | pronë publike, do të përfshihen në projektet e asfaltimit. Kjo mundësohet falë mjeteve të mjaftueshme të destinuara specifikisht për asfaltimin e infrastrukturës rrugore, të cilat janë paraparë në buxhetin e vitit në vijim. Për rrugicat që ndodhen në pronësi private ose me status të paqartë pronësor, do të shqyrtohen mundësitë ligjore për zgjidhje të mëtejshme, në bashkëpunim me banorët dhe institucionet përkatëse. Komuna mbetet e përkushtuar për përmirësimin e infrastrukturës në të gjitha lagjet, sipas prioriteteve dhe mundësive buxhetore. |
| Rrugica, trotuar, ujësjellës, fushë sportive, ndriçim, lidhje rrugore | Kadri Ajazi | Pjesërisht pranuar | Ujësjellësi: nuk mund të bëhet për shkak të hetimit; fusha sportive: do ndërtohet/lejohen fushat ekzistuese; trotuaret: shqyrtohen sipas prioritetit |
| Kanalizim, fidanë dhe ujitje, ndriçim, asfaltim rrugësh, rrugë për varreza/parking, trotuar, fushë sportive | Murat Elshani | Pjesërisht pranuar | Kërkesat do listohen dhe shihen sipas prioritetit; disa punë janë në proces; për fushën sportive do vlerësohet nevoja |
| Muri mbrojtës, zgjerim rrugë/trotuar, lidhje rrugësh, kanalizim, hapje rruge, park nacional | Imri Bajraktari | Pjesërisht pranuar | Nëse ka ndihmë nga qeveria, do shqyrtohet |
| Ndriçim, asfaltim, përmirësim ujësjellësi, shëtitore, asgjësim gropë septike, shkollë (ndriçim/rrethojë/amb ulancë), rrugë dhe rrethojë varrezash | Zekë Kluna | Pjesërisht pranuar | Jo përgjigje direkte në tekst, por në logjikë do shqyrtohet në bazë prioriteti |
| Kopsht për fëmijë afër shkollës | Jahir Beqiri | Refuzohet | Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën për ndërtimin e një kopshti për fëmijë në afërsi të shkollës dhe vlerëson se nevoja për hapësira të reja për arsimin parashkollor është legjitime dhe me rëndësi për komunitetin. Megjithatë, është njoftuar se projektet e tilla aktualisht janë duke u sanksionuar nga niveli qendror, për shkak të mospajtimit për të rritur numrin e të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | punësuarve në sektorin e arsimit parafillor. Kjo pengesë lidhet kryesisht me çështjen e stafit – ku, pavarësisht mundësisë për ndërtim infrastrukturor, mungesa e miratimit për angazhimin e stafit të ri nga niveli qendror e bën të pamundur realizimin e projekteve të reja të këtij lloji. Komuna do të vazhdojë të ndjekë dhe të avokojë në vazhdimësi për krijimin e kushteve më të mira në këtë sektor, përfshirë edhe mundësinë e realizimit të kërkesës në fjalë, sapo të krijohen kushtet ligjore dhe buxhetore për të. |
| Kanalizim, rrugë kryesore, mbrojtëse trotuari, fushë sportive, rruga Hysni Murseli | Habib Gashi | Pjesërisht pranuar | Rruga kryesore mund të riparohet; Hysni Murseli ka filluar por ka ngecur; fusha do shqyrtohet |
| Ndriçim, asfaltim rrugicash | Islam Syla | Pjesërisht pranuar | Të bëhet kërkesë me shkrim për shqyrtim |
| Asfaltimi i rrugëve Mehmet Gradica, 28 Shkurti, Gani Maliqi | Hafiz Muja | Pjesërisht pranuar | Disa rrugë nuk janë të parapara për momentin, disa mund të riparohen; Gani Maliqi do të përfshihet në projekte 2026-2028 |
| **SUBVENCIONE** | | | |
| **Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim** | **Emri i personit/organizatës** | **Statusi i kërkesës** | **Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues** |
| Qendër ditore për persona me aftësi të kufizuara, subvencione, transport falas | Halit Gashi | Pjesërisht pranuar | Ka kufizime buxhetore dhe ligjore; disa shërbime janë nën nivelin qendror; disa subvencione janë dhënë, pritet të mundësohen përsëri |
| Rritja e buxhetit për sektorin e bujqësisë | Mehmet Krasniqi (Fermerët e Drenasit) | Pjesërisht pranuar | Të përcaktohen fushat ku kërkohet më shumë subvencionim, do mbështeten edhe nga donatorët |
| Bilancimi i buxhetit kulturë/rini/sport, dyfishimi i subvencioneve | Izet Avdyli (Klub "Rifat Kukaj" Drenas) | Pjesërisht pranuar | Komision i pavarur bën vlerësimin dhe ndarjen sipas aktiviteteve |
| Subvencionim me kioska | Sabrije Islami (Shoqata e Grave) | Refuzuar | Puna është vlerësuar, por nuk hyn në kuadër të buxhetit aktual |
| Subvencione, objekt për aktivitete, transport | Përfaqësuesi i Shoqatës së | Pjesërisht pranuar | Është tentuar të ndihmohet, nuk u votua në kuvend; ka mungesë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | të Shurdhërve | | hapësire; tenderi për transport nuk pati ofertues |
| Përkrahja e fëmijëve të veteranëve në biznes | Florije Uka | Pjesërisht pranuar | Ka pasur grante për rini dhe start-up, mundësi për përkrahje ekziston |
| Rritja e subvencioneve për kulturë | Gentrit Mulaku (Ansambli Shqipet e Drenicës) | Pjesërisht pranuar | Grupi punues në shqyrtimin e kë shqyrtimin e kësaj kërkese siguruan ka patur dhe do të ketë rritje të subvencioneve edhe në të ardhmen. |
| Subvencionim me pajisje, hapje dyqani | Fitore Fetahu | Pjesërisht pranuar | Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën për mbështetje me pajisje për hapjen e një biznesi të vogël dhe ka vlerësuar se kjo kërkesë bën pjesë në fushën e subvencioneve dhe mbështetjes për ndërmarrësinë lokale. Në këtë drejtim, është udhëzuar që kërkuesi të ndjekë procedurat përkatëse pranë Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ku shpallen thirrjet publike për subvencione, në përputhje me kriteret dhe planifikimet buxhetore të vitit. Komuna mbetet e angazhuar në përkrahjen e nismave private që krijojnë vende pune dhe zhvillim ekonomik lokal, dhe inkurajon aplikimin në kohë të rregullt në thirrjet që shpallen gjatë vitit. |
| Subvencione për prodhuesit e perimeve dhe fermerët | Fitim Istogu | Pjesërisht pranuar | Fermerët të përcaktohen në fushat për subvencion dhe të ndjekin thirrjet e ministrisë. |
| **MALLRA & SHËRBIME** | | | |
| **Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim** | **Emri i personit/organizatës** | **Statusi i kërkesës** | **Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues** |
| Mirëmbajtja e liqenit, kontejnerë, ndihmë për garë memoriale | Florim Kiqina | Pjesërisht pranuar | Liqeni është pronë e KEK-ut, komuna nuk mund të investojë; pastrimi është bërë; gara do mbështetet financiarisht |
| **PYETJE/KËRKESË PËR INFORMACION/SUGJERIME** | | | |
| **Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim** | **Emri i personit/organizatës** | **Statusi i kërkesës** | **Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues** |
| Diskutim për projektet e papërfunduara | Xhafer Dobërdolani | Koment | Grupi punues ka shqyrtuar me kujdes diskutimet dhe komentet e parashtruara lidhur me projektet e papërfunduara dhe ka theksuar se kjo çështje është me natyrë të tillë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | që kërkon trajtim të veçantë. Për këtë arsye, u vlerësua se ajo nuk mund të adresohet në kuadër të këtij takimi, por do të trajtohet në një takim tjetër të posaçëm, më të përshtatshëm për diskutime të kësaj natyre.<br><br>Ky takim do të organizohet në kuadër të raportimit të Kryetarit të Komunës, ku qytetarëve u jepet mundësia të shprehin shqetësimet e tyre dhe të paraqesin propozime konkrete, përfshirë edhe projektet që kërkojnë ndjekje apo përfundim në periudhën e ardhshme buxhetore. |

## KËRKESAT SI REZULTAT I DËGJIMEVE BUXHETORE TË MBAJTURA PËR PROJEKT-PROPOZIM BUXHETIN PËR VITIN 2026 – EKZEKUTIVI KOMUNAL

| INVESTIME KAPITALE | | | |
|---|---|---|---|
| **Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim** | **Emri i personit/organizatës** | **Statusi i kërkesës** | **Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues** |
| Ndriçim publik; asfaltim rrugicash "Mentor Kiçina" dhe "Vëllezërit Elshani"; shtrim kockash para hyrjes së shkollës | Semedin Kiqina<br>Fshati Baicë | | Ndriçimi publik do të realizohet brenda vitit; asfaltimi dhe shtrimi i rrugicave planifikohet sipas projektit buxhetor. |
| Asfaltim rruge 80 m; ndriçim publik; kanalizim | Berat Kiçina<br>Lagja Kiçina, Baicë | | Rruga ishte pjesë e projektit, por u vonua për shkak të shkurtimeve buxhetore. Do të vendoset baza dhe do të rregullohet kanalizimi. |
| Furnizim me ujë për Krajkovën;<br>Ndriçimi i rrugës drejt varrezave të dëshmorëve;<br>Mungesë shtyllash elektrike në lagjen Behrami | Arben Haziri<br>Damanek dhe Krajkovë | | Furnizimi me ujë do të kryhet nga KRU "Prishtina";<br>Ndriçimi publik është në procedurë - OSHP; Vendosja e shtyllave elektrike në lagjen Behrami duhet të bëhet nga KEK, pastaj ne vendosim ndriçimin nëper shtylla. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 122 mijë euro janë të parashikuara për fusha sportive në Korroticë, Komoran dhe Arllat.<br>Kërkesë për renovim të fushave sportive. | Burim Bujupi<br>Përfaqësues nga lagja Bujupi | | Kodi i Drejtorisë së Kulturës parasheh buxhet për fusha sportive. |
| Shumica e kërkesave të bëra më herët janë realizuar.<br>Kërkesë për ndriçim publik në një rrugë ku nuk ka shtylla betoni – të gjendet një zgjidhje alternative.<br>Ura e vendit ka nevojë të rrethohet për shkak të rrezikut për fëmijët (thellësi e madhe).<br>Kërkesë nga banorët për një park të vogël pranë kroit, si vend pushimi për qytetarët. | Urim Gashi<br>Banor i lagjes Gashi | | Faleminderit për bashkëpunimin dhe për angazhimin e vazhdueshëm të qytetarëve.<br>Shumica e kërkesave të paraqitura më herët janë realizuar, ndërsa për kërkesat e reja janë marrë në shqyrtim hapat për zbatim.<br>Sa i përket ndriçimit publik në rrugën pa shtylla betoni, komuna do të shqyrtojë një zgjidhje alternative teknike për vendosjen e ndriçimit në atë segment.<br>Ura e vendit do të rrethohet për të shmangur çdo rrezik, veçanërisht për fëmijët, ndërsa kërkesa për ndërtimin e një parku të vogël pranë kroit do të shiqohet mundesia për t'u përfshrë në planin e investimeve në hapësirat publike rekreative. |
| Riparimi i urës në rrugën për në fshatin Shtrubullovë; pastrimi i kanalizimit përreth sheshit për shkak të erërave të këqija; lirimi i trotuareve; shtrimi me kocka i trotuarit në rrugën nën hekurudhë deri te xhamia. | Habib Tahiraj<br>Drenas I | | Komuna është në dijeni për këto çështje dhe ka paraparë ndërhyrje në kuadër të mirëmbajtjes së infrastrukturës lokale. Riparimi i urës në rrugën për në Shtrubullovë, jemi në pritje të rregullimit të shtratit të lumit përreth asaj ure, dhe kjo është nën kompetencë të Ministrisë. Pastrimi i kanalizimit përreth sheshit për eliminimin e erërave të këqija, lirimi i trotuareve dhe shtrimi me kocka i trotuarit nga rruga nën hekurudhë deri te xhamia janë pjesë e planit të punimeve që do të realizohen brenda afatit të përcaktuar. Ekipet përkatëse janë njoftuar dhe do të veprojnë sipas prioritetit dhe nevojës në terren. |
| Lidhja e rrugës Tahir Krasniqi me rrugën | Murat Elshani Gllobar | | Kemi plan ta shtrijmë rrugën nga stadiumi me bari sintetik deri te |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Izet Elshani, për shkak të qarkullimit të madh të automjeteve deri te pishat. | | | pishat, që do të lehtësonte qarkullimin edhe për fshatin Gllobar. |
| Asfaltimi i disa lagjeve. Ndriçim publik, pasi disa rrugica kanë mbetur pa funksionim të ndriçimit. | Besjan Murtezi Shtrubullovë | | Të gjitha ato që i permende tashme janë ne proces e sipër dhe brenda një periudhe shume të shkurtet do të finalizohen. |
| Në Vasilevë ka mbetur një rrugë pa asfaltuar. Në Poklek të Ri mungon ndriçimi. Në Poklek të Vjetër, në lagjen Bucolli mungon kanalizimi. Gropa septike ende nuk është sanuar dhe gjendet sipër ujit të gazuar. | Zekë Kluna<br>Poklek i Ri, Poklek i Vjetër dhe Vasilevë | | Faleminderit për vërejtjet dhe kërkesat e paraqitura. Komuna është në dijeni për këto çështje dhe ato tashmë janë përfshirë në planin e punimeve të radhës.<br>Asfaltimi i rrugës në Vasilevë, vendosja e ndriçimit publik në Poklek të Ri dhe ndërtimi i kanalizimit në lagjen Bucolli të Poklekut të Vjetër do të trajtohen në fazat e ardhshme të investimeve. Sa i përket gropës septike, ekipi përkatës do të dalë në terren për sanimin e menjëhershëm dhe për të garantuar siguri mjedisore. |
| Parking për banorët rezident.<br>Shkolla "Rasim Kiçina" – a ka kritere për pranimin e nxënësve të rinj? Ka raste që fëmijët vijnë nga lokalitete të tjera, duke krijuar mbingarkesë në klasa. Gjithashtu, a mund të ndërtohen tualete jashtë objektit për shkak të mirëmbajtjes më të lehtë?<br><br>Sqarim për furnizimin me ujë të pijshëm, pasi ka thashetheme për problemet. | Shpend Shala<br>Banor në Drenas | | Problemi i parkingjeve është i madh. Kërkesat janë të shumta dhe duhet vendosur nëse do të jenë me pagesë apo pa pagesë. Për momentin ka edhe keqpërdorim nga vetë banorët.<br><br>Muhamet Gjoka, Drejtor i Arsimit: Zhvendosja e tualeteve jashtë objektit të shkollës është e pamundur.<br><br>Furnizimi me ujë të pijshëm është detyrë dhe obligim i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "KRU Prishtina". Fatkeqësisht kjo kompani shpesh nuk i kryen detyrimet ndaj qytetarëve dhe shumë lokalitete mbesin pa ujë. Ndërkohë, komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet e saj ndaj qytetarëve për këtë çështje. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Pjesë e urës në rrugën Xhevë Lladrovci.<br>Pjesë të kanalizimeve në lagjen Berisha kanë disa prishje.<br>Te rrethi i urës duhet të vendosen gilindera, pasi aty qarkullojnë nxënës afër shkollës dhe paraqet rrezik. | Shaban Berisha, banor i fshatit Gllanasellë | | Çështjes së kanalizimeve, është kompetencë e shërbimeve publike dhe punimet kryhen nga kompania e kontraktuar për këtë qëllim. Ndërsa për zonën tek rrethi i urës, do të angazhohet drejtoria përkatëse për të shqyrtuar mundësinë e intervenimit, formën dhe kapacitetet që ekzistojnë, duke theksuar se kjo është një çështje me rëndësi që do të trajtohet me prioritet. |
| Rruga prej mullirit deri në rrugën kryesore të rregullohet me zhavorr.<br>Rrugët anësore brenda fshatit të lidhen dhe të rregullohen.<br>Vazhdimi i rrugës Adem Berbatovci – vetëm asfalti ka mbetur për t'u hedhur.<br>Ndriçimi publik ka mbetur në disa pjesë pa përfunduar. | Qerim Berbatovci, Përfaqësues i fshatit Godanc | | Njëra prej këtyre kërkesave mund të realizohet edhe brenda këtij viti, pasi kontrata për implementimin e projektit të ndriçimit publik tashmë është nënshkruar dhe kompania do të fillojë punimet në terren brenda pak javësh. Edhe projektet e tjera të përmendura do të realizohen gjatë vitit të ardhshëm, pasi janë projekte që mund të përballohen financiarisht dhe nuk kanë kosto të madhe buxhetore. |
| Rrethojën e shkollës në Gradiçë. Punimet kanë filluar para 2-3 vitesh dhe kanë mbetur në gjysmë.<br>Mbeturinat pranë shkollës nuk janë hequr.<br>Kanalizimi te lagjja Dibrani dhe te lagjja Uka – punimet kanë filluar por operatori nuk ka punuar tash e dy javë.<br>Rruga për tek shtëpia e Lec Gradiçes është kërkuar edhe vitin e kaluar. Po ashtu edhe për lagjen | Hafiz Muja, Administrator, Gradicë-Likoshan | | Drejtoria Komunale për Arsim, thekson se projektet që kanë mbetur në gjysmë do të përfundohen. Edhe pas sanimit të gropave, prap janë prishur dhe kompania e ka përgjegjësi të i sanoj ato. Planifikohet të ndërtohet rruge e re, por deri atëherë duhet të sanohen gropat për të mos u bërë të pakalueshme. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Fazliu, Uka dhe Dervishi – rreth 800-900 metra rrugë që lidhen tri lagje.<br>Nevojitet të shtrihen 300 metra rrugë zhavorr te shtrati i vëllezërve Fazliu.<br>Ujësjellësi në Likoshan është bërë, por nuk është funksional sepse nuk lëshon ujë.<br>Janë djegur dhjetëra hektarë tokë bujqësore.<br>Rruga Gani Maliqi është e gjatë dhe jo e përfunduar. Aty jetojnë tri familje që i dërgojnë fëmijët në shkollë me vetura. | | | |
| Nuk ka trotuar te lagjja Berisha, gjë që paraqet rrezik për nxënësit. | Lavdim Berisha, Lagjja Berisha, Gllanasellë | | Komuna nuk ka tokë publike në atë zonë. Për të bërë projektin e trotuarit duhet të blihet toka private, gjë që kërkon buxhet shtesë. |
| Parking për shkollën është emergjent.<br>Rregullimi i kulmit të shkollës është i domosdoshëm – ka rrjedhje gjatë reshjeve. Është tentuar të rregullohet nga punëtorët e shkollës, por pa sukses.<br>Fusha e sportit kërkohet nga prindërit të rregullohet me bar artificial ose ndonjë formë tjetër.<br>Ndërhyrja në këto pika është e domosdoshme | Arsim Avdyli, Drejtor i Shkollës në Dobroshec | | Drejtoria Komunale për Arsim ka pranuar kërkesat, do ta shqyrtoj mundësinë e parë për t'i sanuar defektet.<br>Edhe mundësia e investimeve ne projektet tjera do të analizohen. |
| Izolimi i shkollës është i dobët. | Ilir Nika, Drejtor i shkollës në Gllanasellë | | Kemi aplikuar në fondin për efiçiencë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Disa dritare janë ende metalike dhe kërkojnë ndërhyrje urgjente. | | | |
| Për shkollën falënderon, pasi çdo kërkesë është realizuar nga Drejtoria e Arsimit. Gjashtë lisat që njihen në fshatin Likoshan të mbrohen që të mos shkatërrohen. | Bujar Tahiri, Banor i Likoshanit | | Drejtorisë së Arsimit i shkon mirënjohja për përkushtimin dhe realizimin e çdo kërkese të paraqitur nga shkolla.<br><br>Sa i përket gjashtë lisave që njihen në fshatin Likoshan, komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtjen e tyre si pasuri natyrore dhe simbol i trashëgimisë së fshatit, duke parandaluar çdo dëmtim apo shkatërrim të mundshëm. |
